



Në bazë të nenit 7, 8, 9, 10. dhe 11. Vendimit për kriteret, mënyrën dhe procedurën e alokimit të mjeteve për organizatat joqeveritare („Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës“, nr. 42/18.),

**KRYETARI I KOMUNËS SË ULQINIT**  
**S h p a l l**  
**KONKURS PUBLIK**  
**PËR ORGANIZATAT JOQEVREDITARE TË CILAT VEPROJNË**  
**NË NJË FUSHË TË CAKTUAR PRIORITYARE ME INTERES PUBLIK PËR**  
**PROPOZIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT PËR ALOKIMIN E MJETEVE PËR**  
**PROJEKTET E ORGANIZATAVE JOQEVREDITARE PËR VITIN 2024**

Kandidatin për anëtar të Komisionit mund ta propozojë Organizata joqeveritare e regjistruar në Mal të Zi me seli në Komunën e Ulqinit, e cila i plotëson këto:

1. që është e regjistruar në regjistrin e organizatave joqeveritare, së paku një vit para publikimit të thirrjes publike;
2. të ketë selinë në territorin e Komunës;
3. që në vitin paraprak ka realizuar një ose më shumë projekte, ose ka marrë pjesë së paku në një fushatë, ose ka realizuar së paku dy aksione të njehershme;
4. që më shumë se gjysmën e anëtarëve të organeve udhëheqëse të organizatës joqeveritare nuk janë anëtarë të partive politike, funksionarë publikë, nëpunës ose zyrtarë shtetërorë ose lokalë, udhëheqës ose të punësuar në institucione publike dhe shoqëri ekonomike themelues i të cilave është shteti ose komuna.

Organizata joqeveritare me propozimin e kandidatit duhet të dorëzoj si vijon:

1. kopjen e aktvendimit të regjistrimit në regjistrin e organit të administratës shtetërore kompetent për regjistrim dhe udhëheqjen e evidencës për organizatat joqeveritare;
2. kopjen e Statutit të organizatës;
3. dëshminë për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve në vitin paraprak: kontratën për financim, broshurat, fletushkat, fletëpalosjet, artikujt e gazetave e tjerë;
4. deklaratën e personit të autorizuar për përfaqësim dhe paraqitje të organizatës joqeveritare që në organin udhëheqës të organizatës joqeveritare shumicën nuk e përbëjnë anëtarët e partive politike, funksionarët publikë, nëpunësit ose zyrtarët shtetërorë ose lokalë, udhëheqës ose të punësuar në institucione publike dhe shoqësi ekonomike themelues i të cilave është Shteti ose Komuna.

Duke u bazuar në kushtet e sipërpërmendura Organizata joqeveritare e cila propozon kandidatin për anëtar të Komisionit, duhet që për kandidatin të dorëzojë sa vijon:

1. fotokopjen e vërtetuar të letërnjoftimit;
2. biografinë e kandidatit me të dhënat që ka përvojë në shkrimin dhe realizimin e projekteve;
3. deklaratën e kandidatit që nuk është anëtar i partive politike, funksionar publik, nëpunës ose zyrtar shtetëror ose lokal, udhëheqës ose i punësuar në institucione publike ose shoqësi ekonomike themelues i të cilave është Shteti ose Komuna dhe
4. deklaratën e kandidatit që e pranon kandidaturën për anëtar të Komisionit.

Kandidat i organizatës joqeveritare për anëtar i Komisionit mund të jetë personi i cili:

1. ka shtetësinë e Malit të Zi;
2. ka vendbanimin në territorin e Komunës;
3. ka përvojë në shkrimin dhe realizimin e projekteve;
4. nuk është anëtar i partive politike, funksionar publik, nëpunës ose zyrtar shtetëror ose lokal, udhëheqës ose i punësuar në institucione publike ose shoqësi ekonomike themelues i të cilave është Shteti ose Komuna.

Aplikimet në konkurs me dokumentacionin përcjellës dorëzohen në zarf të mbyllur direkt në Byronë e qytetarëve ose me postë në adresën: Komuna e Ulqinit, Bulevardi Gjergj Kastrioti Skenderbeu, Kabineti i Kryetarit.

Konkursi publikohet në web faqen e Komunës së Ulqinit, në tabelën e shpalljeve, dhe përmes transmetuesit publik lokal.

Afati për propozimin e kandidatit është 30.ditë nga dita e shpalljes së konkursit publik.

Aplikimet e paplota dhe jashtë kohës së caktuar nuk do të shqyrtohen. Informatat për të gjitha çështjet me rëndësi për të marrë pjesë në konkurs mund të merren çdo ditë punë prej orës 09:00 deri në orën 14:00 në zyrën nr. 26, Sekretarijati për kulturë, sport, rini dhe veprimtari shoqërore, personi për kontakt: Aldina Nikočević ose përmes e-mail-it: blerim.gjeloshi@gmail.com

KOMUNA E ULQINIT  
KRYETARI I KOMUNËS

Omer Bajraktari

